



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **13.12.2021**, me fillim në ora **10:00**. Mbledhjen e kryesoi anëtari me i vjetër i Kuvendit z. **Rasim Fazliu**. Konstatohet se kuorum, për mbajtjen e mbledhjes kemi, fillimisht e përshëndes Kryetarin e Komunës z. **Smajl Latifi**, anëtarët e Kuvendit Komunal, përfaqësues të mediave dhe gjithë të pranishmit në sallë. Sot kemi një pikë të rendit të ditës.

REND DITE

1. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Rahovecit.

RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 4/259 Nr. ifaq/Br.str/No.pg 3

Data/Datum/Date 25.01.2022

Rasim Fazliu - Para se me procedua me pikën e rendit të ditës, fjalën e ka zyrtari ligjor që të na tregoj procedurat se si duhet me vazhdua me tutje.

Isak Hoti – Isak Hoti – Faleminderit kryesues, kryetar, delegat të nderuar dhe gjithë ju të pranishëm. Konform udhëzimit administrativ Nr.2009/01 udhëzimi administrativ për procedurën e zgjedhjes së kryesuesit të kuvendit të komunës, që po e citoj komplet udhëzimin: ku secili subjekt politik, nismë qytetare apo kandidat i pavarur i përfaqësuar në kuvendin e komunës ka të drejtë që në radhët e anëtarëve të kuvendit të komunës të propozoj një anëtar për kryesues të kuvendit të komunës. Kuvendi i komunës me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të komunës formon komisionin për mbarëvajtjen e procesit të votimit, i cili përbëhet nga 3-5 anëtarë. Komisioni për votim është përgjegjës që ti numëroj votat dhe të komunikoj për rezultatet e votimit para anëtarëve të kuvendit. Votimi për zgjedhjen e kryesuesit të kuvendit të komunës bëhet me votën e fshehtë. Për tu zgjedhur në votimin e parë kandidati i propozuar për kryesues të kuvendit të komunës duhet të marrë më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kuvendit. Nëse pas votimit të parë asnjëri prej kandidatëve të propozuar për kryesues të kuvendit të komunës nuk merr më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kuvendit të komunës atëherë dy kandidatet të cilët kanë fituar numrin më të madhe të votave shkojnë në votimin e dytë. Kandidati që merr më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kuvendit të komunës atëherë në rundin e dytë zgjidhet kryesues i kuvendit të komunës. Pika e 4, nëse edhe pas votimit të dytë asnjëri nga kandidatët nuk ka fituar shumicën e kërkuar si në pikën 3 të këtij udhëzimi administrativ atëherë shkohet në votimin e tretë dhe në votimin e tretë kryesuesi i kuvendit të komunës zgjidhet kandidati i cili merr më shumë se gjysmën e votave të anëtarëve të përhershëm dhe që votojnë në propozimin në mbledhjen e kuvendit të komunës. Atëherë nëse edhe në votimin e tretë nuk zgjidhet kryesuesi i kuvendit të komunës atëherë i tërë procesi për zgjedhjen e kryesuesit të kuvendit të komunës përsëritet dhe fillon prapë nga e para. Gjithashtu më duhet të potencoj se datën e fundit për zgjedhjen e kryesuesit e kemi 3 janar 2022.

Rasim Fazliu – Tash sipas procedurës vazhdojmë me propozimet nga secili grup politik për kandidatin për kryesues të kuvendit. Kështu që e ftoj përfaqësuesin nga grupi i AAK-së që të bëjë propozimin.

Fatmir Iska – Ne si grup i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e propozojmë asambleistin e zgjedhur me votën e qytetarëve z. Afrim Dina, ish kryesues i Kuvendit të Komunës, i cili ishte një menaxher i mirë që ka marrë vlerësime edhe prej kolegëve asambleistë në mandatin e kaluar, po ashtu një pedagog dhe familjar i

mirë, kështu që ju ftoj të gjithëve pa dallim partie me përkrah z. Afrim Dina për kryesues të kuvendit të komunës.

Leonard Morina – Përshëndetje kryesues i seancës, kryetar dhe ju kolegë asamblistë. Lëvizja Vetëvendosje nuk ka kandidat për kryesues të Kuvendit.

Burim Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Lidhja Demokratike e Kosovës nuk ka kandidat për kryesues.

Bejtullah Deliu – Përshëndetje kryesues, kryetar dhe ju asambleistë. Edhe grupi i Partisë Demokratike të Kosovës nuk kemi kandidat për kryesues të Kuvendit.

Sipas procedurës duhet me zgjedh komisionin për verifikimin dhe përcjelljen e votimit për kryesues të Kuvendit, ku duhet të jenë prej 3-5 anëtar të komisionit, ku secili grup politik duhet të propozoj. Gjithashtu duhet të marr propozimin tuaj që për sa anëtarë të komisionit jeni dakord. Pra, ju jeni që të jenë 5 anëtar të komisionit.

Burim Krasniqi - Mendoj se administrata e kuvendit mundet me na dhanë udhëzime se cili nen i rregullores së Kuvendit i Udhëzimit Administrativ apo i statutit e ndalon diskutimin në këtë pikë të rendit të ditës dhe se ju më thoni se në bazë të këtij neni është e ndaluar atëherë unë nuk do të flasë.

Isak Hoti- Udhëzimi administrativ 2009/1 nuk parasheh asnjë pikë ku ka diskutime sot dhe nuk do të thotë që e ndalon, por, nuk parasheh diskutimet gjatë zgjedhjes së kryesuesit. Pra, asnjë pikë e udhëzimit administrativ nuk i parasheh diskutimet rreth kësaj çështjeje.

Burim Krasniqi – Faleminderit kryesues, unë kisha pas qejf që kjo seancë me qenë me solemnitet dhe jo në formën se kush po mundet me tregua forcë apo autoritet. Unë jam deklaruar qysh në fillim si kryetar i LDK-së pavarësisht rezultateve mbetet pjesë e opozitës dhe nuk e ka vullnetin e koalicionit me askënd por megjithatë po me vjen me u ndie keq edhe për asamblistët e AAK-së dhe gjithashtu edhe për të propozuarin për kryesues të kuvendit, por, edhe për secilin delegat të asamblesë komunale kur tentohet të nënçmohet skajshmërisht asambleja komunale. Nuk e di se si mundet me paramendua me funksionu një asamble komunale kur në seancën e parë është e ofenduar dhe kur tentohet me zgjedh kryesuesin pa asnjë marrëveshje me ndonjërin prej partive politike që garanton numrin në asamble komunale. Kjo për mua është e papranueshme dhe për të gjithë të tjerët, nëse asamblistët e LDK-së do te qëndronin në një seancë apo e kishin lejua kryetarin e komunës me luajt me delegat te asamblesë komunale. Kështu që kryetar i komunës, nuk e di që janë 16 numra për zgjedhjen e kryesuesit zyrtarisht dhe po më vjen shumë keq që më duhet me thënë pasi këtu është ardh me tendencën e funksionimit të asamblesë duke provuar me i përçarë grupet e asamblistëve dhe duke provuar që nga vota e fshehtë që mos rastësisht po del ndonjë votë që me u bë 16 vota dhe me pastaj me drejtua gishtin te ndonjëri kandidat brenda grupeve, që në një formë apo tjetrën nuk ka vullnet të funksionimit normal të asamblesë, nuk ka vullnet të realizimit të projekteve të premtuara që keni marr besimin e qytetareve dhe për këtë ju uroj sukses pasi ka qenë vota e qytetareve që ju me qenë kryetar i komunës dhe nuk e kontestoj në asnjë format, por, duhet t'i bëni numrat me cilindo parti dhe zgjidhni kryesuesin dhe gjithashtu shtyjeni projektet tutje dhe kemi format të funksionimit të asamblesë komunale. Pra unë si kryetar i LDK-së dhe si udhëheqës i grupit te asamblistëve te LDK-së po ju informoj që ne këtë seancë nuk mund te marrim pjesë deri ne fund pavarësisht numrit dhe te shohim nëse vërtet ka numra për zgjedhjen e kryesuesit, kështu që ju uroj suksese ne zgjedhjen e kryesuesit. Pra LDK e lëshon seancën.

Kryetari - Faleminderit kryesues i seancës, Shef i Zyrës Ligjore z. Isak Hoti, anëtar të Kuvendit, monitorues, media dhe gjithë të pranishmit në sallë. Sipas udhëzimit administrativ, besoj se është e qartë që secili grup politik dhe madje edhe kandidat i pavarur mund të propozohet si kandidat për kryesues. Kështu që një grup politik ka bërë një propozim dhe kjo përkundrazi i inkurajoj edhe grupet e tjera politike që te bëjnë propozimet e veta pavarësisht rezultateve dhe besoj se kjo është gjëja më normale që duhet të bëj kuvendi i komunës së Rahovecit. Pra, nëse duam me pas ceremoni solemne të zgjedhjes së kryesuesit

atëherë është pak e çuditshme se si grupet politike nuk kanë ide për ndonjë kandidat të mundshëm për të qenë kryesues dhe kjo nuk është faj i kryetarit të komunës i cili i ka fituar zgjedhjet. Pastaj, se si do të funksionoj opozita dhe pozita dhe a do të këtë proces normal në funksionim në relacionet kuvend ekzekutiv, ajo do të mbetet të shihet. Mirëpo në seancën konsultive të kuvendit të komunës e kemi shembullin më të mirë në konstituimin e kuvendit të Kosovës, ku partia fituese e zgjedhjeve e propozon kandidatin dhe zakonisht votohet siç është edhe e përcaktuar edhe me vendim të Gjykatës Kushtetuese madje nuk e di se a duhet vlejë ky shembull, edhe në kuvendet komunale pasi është lehtë me than se e lëshoj seancën dhe me ikë prej sfidave pasi është e drejtë secila me propozu, secila parti politike që është e përfaqësuar në kuvend dhe ai që merr shumicën e votave edhe fiton. Kështu që nuk mendoj se funksionimi i kuvendit duhet të nisët nga sot, pasi puna e kuvendit të Komunës dhe puna e kryetarit dhe ekipit të tij pas konstituimit të organeve obligative, pasi obligim ligjor është edhe zgjedhja e kryesuesit pastaj dy komitetet obligative si Komiteti për Politike dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete dhe tek atëherë fillon të shihet funksionimi i organeve të zgjedhura në këtë rast i Kuvendit të Komunës, por, edhe relacionet që ka kryetari i Komunës me ekipin e tij me Kuvendin e Komunës që janë relacione ligjore që duhet me i pas dhe nuk mendoj se duhet me fillua nga sot. Kështu që unë mendoj se edhe Burimi, Bejtullahu, por, edhe Leonardi nuk besoj që kanë qysh ne fillim pozicion frenues. Pra, Kuvendi i Komunës duhet me dhanë shembullin dhe për mua si kryetar i Komunës, është me interes me u zgjedh kryetari i Komunës dhe gjithashtu edhe për ju si anëtar të zgjedhur të kuvendit dhe gjithashtu edhe për qytetaret e komunës është zgjedhja e kryesuesit të kuvendit të komunës dhe sigurisht se do të ishte mirë të zgjidhej sot dhe uroj që të zgjidhet kandidati që merr votat në rundin e parë, të dytë apo të tretë. Pra, është shumë me rëndësi të zgjidhet pasi është pozicion parimor dhe shumë i qartë i kryetarit të Komunës. Nuk do të ishte mirë të shkohej ne modalitete tjera të cilat nuk japin një shembull të themelimit apo kompletimit të themelimit të kuvendit të komunës si institucion duke zgjedhur kryesuesin dhe dy komitete obligative që janë komiteti për politikë dhe financa dhe komiteti për komunitete dhe me pastaj fillojmë me bisedue se a jemi si pozite duke kryer punën dhe gjithashtu edhe opozita duke funksionuar ne punën e saj. Pra, ne kuvendin e komunës partia e cila i bën numrat duhet të zgjidhet kryesues i kuvendit dhe nuk e di pse duhet me prejdukue frikë apo paragjykime pasi vërtet nuk e kuptoj këtë, pasi nuk jam me çdo kusht me u zgjedh i propozuari i aleancës por më brengos fakti se pse nuk po propozoni edhe ju, nuk e di ndoshta ne si pozite duhet me lëshue sallën dhe ju e zgjedhni kandidatin tuaj. Kështu që mund ta provoni edhe ashtu pasi është betejë ligjore, ju mund ta propozoni kandidatin tuaj e qesim ne votim dhe e zgjedhim kryesuesin, por çudia e madhe është se pse nuk keni kandidat për kryesues të kuvendit dhe kjo është brengosëse për subjektet që nuk dëshirojnë me nxjerr kandidatet e vet.

Leonard Morina – Meqenëse kryetari po thotë se ndoshta edhe i kemi numrat atëherë ne si lëvizje Vetëvendosje e lëshojmë seancën e kuvendit dhe ju mund ta zgjidhni kryesuesin e kuvendit.

Bejtullah Deliu – Po ashtu edhe Partia Demokratike e Kosovës e lëshon seancën e kuvendit.

Rasim Fazliu – E ftojme sekretarin që të vërtetoj se a kemi kuorum për vazhdimin e seancës. Atëherë pasi që nuk kemi kuorum, seanca përfundon këtu deri në thirrjen e seancës së radhës.

Procesmbajtësi:

Agim Hoti

